



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, Datë 29.06.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR ZGJERIM TË RRJETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË OPERATORIT "ALBANIAN MOBILE
COMMUNICATIONS (AMC) SH.A", NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE PËR
9 STACIONE BAZË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", nenit 19 të Vendimit nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" dhe Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për zgjerim të rrjetit të komunikimeve elektronike të operatorit "ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS" (AMC) sh.a, nëpërmjet shtimit të antenave për 9 stacione bazë me subjekt kërkues "Energia B" sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
 - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
 - b. Harta e Planvendosjes së Strukturave të 9 stacioneve bazë.
3. Ngarkohet Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
4. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njësitë të Qeverisjes Vendore ku do të vendosen stacionet bazë.
5. Ngarkohet Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA





ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



Znj. MILENA HARITO

MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

